

# Trek



**DASHURIA E TIJ**  
**UDHËZUESI I DREJTUESIT**

**Awana**

1 East Bode Road  
Streamwood, IL 60107-6658 U.S.A.  
awana.org  
(630) 213-2000

© 2014 Awana® Clubs International

1 2 3 4 5 6 23 22 21 20 19 18

Citimet biblike janë marrë nga Bibla, versioni 2009  
E drejta e autorit © SHOQËRIA BIBLIKE SHQIPTARE (ABS) TIRANË  
Përdorur me leje.

**Titulli në original: Trek 2 "His Love" - Leader's Guide**

Copyright 2017 Awana Clubs International  
Originally published by Awana  
1 East Bode Road  
Streamwood, IL 60107-6658 U.S.A.  
awana.org  
(630) 213-2000

Ky libër u mundësua në gjuhën shqipe nga Qendra "IGNIS".  
Për më shumë informacione vizitoni [www.awana.al](http://www.awana.al)

Përktheu: Sara Gjana  
Redaktoi: Linea Simeon  
Korrektoi: Ditjon Dibra

Shtypur në shtypshkronjën "Vision Printing shpk", Tiranë 2023

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla ABS 2009, përdorur me leje nga Albanian Bible Society (A.B.S.). Të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre elektronike, mekanike, fotokopjimi, incizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër, pa marrë leje me shkrim nga botuesi.

# LETËR PËR DREJTUESIN

Përsëritet! Gati për një udhëtim? Do të zhytemi thellë në historinë më të bukur që është treguar ndonjëherë. Ky libër fokusohet në historinë e Perëndisë. Do të nisim një shqyrtim të mënyrës se si të gjitha historitë e Biblës përshtaten së bashku. Nuk do të mbulojmë çdo imtësi, por do të flasim për disa nga temat kryesore të Biblës. Edhe nëse studentët e tu dëgjojnë për herë të parë rreth Biblës apo nëse janë rritur në kishë, kjo histori, historia e Perëndisë, është shumë e rëndësishme. Para se të fillojmë, kemi mundësuar një shpjegim të mënyrës si funksionon *Trek Bible Study*. Kemi përfshirë gjithashtu pritshmëritë e regjistrimit të drejtuesit në një seksion. Gati për të filluar? Nisemi!

## SI TË PËRDORNI LIBRIN E STUDIMIT BIBLIK "TREK"

### **Veprimtaria hyrëse**

Ku të fillojmë? Fillo këtu! Në fillim të çdo mësimi, studentët kanë një veprimtari hyrëse që do t'i prezantojë me mësimin. Ka një hapësirë që ata të krijojnë, të vizatojnë, të ngjisin foto të krijimeve të tyre, të bëjnë lista etj. Të gjithë studentët duhet ta plotësojnë këtë seksion, që drejtuesi ta firmosë.

### **Fjalë kyç**

Çdo mësim ka një fjalë kyç. Fjalët kyç përmbajnë përkufizimin e konceptit të çdo mësimi. Kërkoju studentëve t'i shtojnë këto fjalë në fjalorin e tyre. Fjalët kyç do t'i ndihmojnë me studimet biblike tani, por edhe në të ardhmen.

### **Mendimi kyç**

Mendimi kyç është një përshkrim i asaj që flitet në mësim.

### **Mësimi**

Studimi biblik fillon me një pasazh nga Shkrimi. Mos e anashkalo këtë pjesë! Kërkoju gjithmonë studentëve të fillojnë me leximin e Fjalës së Perëndisë. Pastaj, vazhdo me leximin e studimit.

### **Vargu kyç**

Vargu kyç është ai që duhet mësuar përmendsh. Studentët e tu duhet ta mësojnë vargun, në mënyrë që drejtuesi ta firmosë. Poshtë vargut kyç ka një shpjegim të kuptimit të tij (studentët nuk kanë nevojë të mësojnë përmendsh përmbledhjen që të plotësojnë seksionin). Sigurohu që studentët ta mësojnë vargun dhe të dinë kuptim e tij.

### **Devocionet**

Çdo mësim përmban katër devocione. Çdo devocion nis me një pasazh të vogël nga Shkrimi për t'u lexuar. Pastaj ka disa mendime që duhet t'i rrihni bashkë me studentët dhe disa pyetje që duhet t'u përgjigjeni. Kërkoju studentëve të fillojnë dhe të praktikojnë një kohë me Fjalën e Perëndisë. Studentët duhet ta plotësojnë këtë seksion, në mënyrë që drejtuesi ta firmosë.

### **Çfarë kërkohet që mësuesi të firmosë plotësimin e një seksioni?**

Studentët duhet të plotësojnë veprimtarinë hyrëse në fillim të çdo mësimi.

Studentët duhet të recitojnë vargun përmendsh.


Studentët duhet të plotësojnë devocionet.

SIGUROHU TË VIZITOSH FAQEN AWANA.AL

PËR TË SHKARKUAR MATERIALET SHITESË TË TREK-UT.

Kemi përfshirë faqet prezantuese si burim mësimor shtesë. Çdo faqe përmban një nënfaqe me titullin, një me vargun kyç, një me përmbledhjen e mësimit dhe një faqe të ndryshueshme që ti mund ta përdorësh kur mëson studentët e tu.



MËSOJE  PËRMENDSH

*M'u duk e mirë edhe mua, pasi i hetova të gjitha gjërat me kujdes që nga fillimi, të t'i shkruaj sipas radhës, fort i nderuari Teofil, që ti të njohësh vërtetësinë e gjërave që të kanë mësuar.*

Luka 1:3-4

- Luka dëshironte që çdokush të njihnte faktet.
- Luka kush?
- Luka i shërbeu një numri të pafund njerëzish me shkrimet e tij.

Shkruaj përmbajtjen tënde këtu.

- Shkruaj përmbajtjen tënde këtu.
- Shkruaj përmbajtjen tënde këtu.
- Shkruaj përmbajtjen tënde këtu.

# MËSIMI 1.1 RRUGA drejt MADHËSHTISË

## SEKSIONI 1: PËRGATITE PËRMBLEDHJA E MËSIMIT:

Madhështia. Njerëzimi është konsumuar prej saj që prej fillimit të kohës. Kemi ndërtuar kulla, monumente, kemi pushtuar kombet, kemi kërkuar zyra dhe jemi siguruar që emrat tanë të jehojnë përgjatë gjithë historisë. Që nga momenti kur gjarpri tundoi Adamin dhe Evën, me idenë se ata mund të ishin të mëdhenj, madje më të mëdhenj se Perëndia, është bërë një betejë ku zemrat e njerëzve kanë luftuar dhe shumë pak kanë dalë fitimtarë.

Mendo pak për këtë. Jezusi erdhi në një kohë të historisë të quajtur *Pax Romana* (viti 27 para Krishtit deri në vitin 180 pas Krishtit) kur madhështia e Romës ishte në kulmin e saj. E gjithë bota e njihte dhe e pranonte madhësinë e Romës. Roma ishte modeli i madhësisë në botë. Edhe sot jetojmë në një kohë kur çdokush kërkon të bëhet mbret. Ka pafundësisht libra për përmirësimin e vetes. Të gjithë kanë mundësinë të ndjekin leksione për përmirësimin e vetes në një fushë të caktuar. Ne tërhiqemi pas pushtetit, pasurisë dhe pozitës. Jezusi erdhi për

ta përmbysur plotësisht idenë tonë të madhësisë. Në mendjen e njeriut, madhështia është arritje egoiste. Në tavolinën e Darkës së Fundit ishin dy vëllezër të quajtur Jakob dhe Gjon (bijtë e Zebedeut). Ata i kërkuan mamasë së tyre të shkonte te Jezusi dhe t'i kërkonte që t'i bënte ata drejtuesit më të rëndësishëm dhe më të fuqishëm në mbretërinë e Jezusit, mbi gjithë dishepujt dhe ndjekësit e tjerë. Kjo do të thotë të jesh një prind shumë kontrollues. Përgjigjja e Jezusit nuk ishte ajo përgjigje që priste. Shqyrto të gjithë Shkrimin dhe do të shohësh se Perëndia shqetësohet më së shumti për gjendjen e zemrës së një personi, dhe jo për pamjen, vendosmërinë apo kualifikimet e mendimeve të njerëzimit. Zemra ka më shumë rëndësi. Vër re se Jezusi nuk thotë që madhështia është diçka e keqe. Ai thotë thjesht se rruga për ta arritur atë nuk është ajo që njerëzit mendojnë apo ndjekin zakonisht. Nuk ka të bëjë me ngjitjen e shkallëve. Në fakt, nuk ka të bëjë me ngjitjen, por me zbritjen. Mateu 20:28 thotë: *Ashtu si Biri i njeriut nuk erdhi që t'i shërbehet, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si shpërblësë për shumë veta.* Ky është shembulli. Pikërisht ky. Mos eja duke menduar se do të të shërbejnë dhe se madhështia ka të bëjë me ty. Ka të bëjë me të tjerët. Në fakt ka të bëjë me një jetë shërbimi të pakushtëzuar ndaj të tjerëve. Perëndia do që ti të jesh i madh. Megjithatë, duhet të kuptosh se Jezusi pret që ne të jemi në shërbim dhe nënshtrim ndaj njëri-tjetrit.

### FJALË KYÇ/

AMBICIE: NJË DËSHIRË E FORTË PËR TË BËRË APO ARRITUR DIÇKA, ZAKONISHT KËRKON VENDOSMËRI DHE SHUMË PUNË

### MENDIMI KYÇ/

NË MËSIMIN 1.1 MËSUAM SE, QË NJË BESIMTAR TË JETË I MADH SI JEZUSI, DUHET TË BËHET MË PARË SHËRBËTOR.

PJESA KRYESORE E SHKRIMIT/  
MATEU 20:20-28

PJESËT DYTËSORE NGA SHKRIMI/  
LUKA 22:27; MARKU 9:35;  
1 E TIMOTEUT 2:6

### MËSOJE PËRMENDSH/



**Ashtu si Biri i njeriut nuk erdhi që t'i shërbehet, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si shpërblësë për shumë veta.**

**Mateu 20:28**

### OBJEKTIVAT E MËSIMIT/

- Studentët do të dinë se rruga e vërtetë drejt madhësisë është t'u shërbehet dhe t'u nënshtrorsh të tjerëve.
- Studentët do të dinë se Jezusi ndryshoi mënyrën si dishepujt e kuptonin madhësinë.
- Studentët do të kuptojnë që, nëse besimtarët duan të jenë të mëdhenj si Jezusi, duhet të bëhen më parë shërbëtorë.

### OBJEKTIVAT E TUA/

Ti i njeh studentët e tu. Në bazë të këtij mësimi, çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

- 
-

## SEKSIONI 2: LUAJE (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe përgatitur kohën e lojërave. Pjesa e parë përmban lojëra dhe ide që janë zgjedhur më parë për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimi. Përdor gjysmën e poshtme të kësaj faqeje për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh studentët e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

**Loja 1** – Mate (Shih librin e lojërave *Awana YM*, faqja 53, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

**Loja 2** – Garë me makarona (Shih librin e lojërave *Awana YM*, faqja 65, për të gjetur listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

**Projekti i shërbesës**— Nëse do të jesh një shërbëtor i madh, fillo nga shtëpia jote. Ndonjëherë është më e lehtë të shkosh në një udhëtim misionar përreth botës dhe t'iu shërbesh njerëzve që nuk njeh. Megjithatë, është gjë tjetër të përlësh veten dhe t'iu shërbesh atyre që janë më pranë teje. Gjatë dy javëve të ardhshme, përpiku të shfrytëzosh çdo mundësi për t'iu shërbyer atyre që jetojnë me ty. Hidh plehrat. Laj enët. Ndhmo vëllain apo motrën me detyrat. Korr barin. Laj rrobat. Pyeti pjesëtarët e familjes si mund t'iu shërbesh këtë javë dhe përmbushi kërkesat e tyre për aq kohë sa janë të arsyeshme dhe të parrezikshme.

PLANIFIKO – ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KOHA:

KALIMI/

Si do t'i bësh të kalojnë nga të qenët të rrëmujshëm në të qenët të gatshëm për të mësuar dhe për t'iu përfshirë në Fjalën e Perëndisë?

IDE:

- Videoklip –
- Inskenime –
- Mikser –
- Adhurim –

LAJMËRIME/

Cilat janë disa gjëra të rëndësishme që studentët duhet të dinë para se të largohen sot?

JO MË SHUMË SE DY!!!

- 
-

## SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUP I MADH)

### MËSIMI I GRUPIT TË MADH/

**Prezantim** – Bëj një listë të shpejtë të disa njerëzve që i njeh personalisht (miq, të afërm etj.) të cilët i mendon si më të mirët në fushat e mëposhtme. Pastaj shkruaj si arritën deri aty. Për shembull, mund të shkruash: Futboll – Tom Smith – ka punuar fort.

FUTBOLL-

KËNDIM -

MATEMATIKË -

TË FOLURIT NË PUBLIK-

HUMOR-

### PLANIFIKO - MËSIMI I GRUPIT TË MADH/

KOHA:

**Prezantimi:**

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

## SEKSIONI 3: MËSOJE (GRUP I MADH)

### MADHËSHTIA KEQKUPTOHET.

Atëherë nëna e bijve të Zebedeut iu afrua bashkë me bijtë e vet, ra përmbys para tij dhe i kërkoi diçka. Dhe ai i tha: “Çfarë do?”. Ajo u përgjigj: “Thuaj që këta dy bijtë e mi të ulen njëri në të djathtën tënde dhe tjetri në të majtën në mbretërinë tënde”. Por Jezusi, duke u përgjigjur tha: “Ju nuk dini çfarë kërkoni; a mund ta pini kupën që unë do të pi...?”

Mateu 20:20–22a

### MADHËSHTIA NUK ËSHTË SIÇ E MENDON BOTA.

Ata i thanë: “Po, mundemi”. Dhe ai u tha atyre: “Vërtet kupën time do ta pini dhe me pagëzimin që unë pagëzohem do të pagëzoheni; por nuk më takon mua ta jap të ulurit në të djathtën time dhe në të majtën time; por është për ata, që u është përgatitur nga Ati im.” Dhe kur të dhjetët e dëgjuan, u indinjuan kundër dy vëllezërve. Por Jezusi i thirri ata pranë vetes dhe u tha: “Ju e dini se të parët e kombeve i sundojnë ato dhe të mëdhenjtë përdorin pushtetet mbi ato.”

Mateu 20:22b–25

#### SHËNIME

---

---

---

### PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT/

- 
- 
- 

### MËSOJE PËRMENDSH: /

**Ashtu si Biri i njeriut nuk erdhi që t'i shërbehet, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si shpërblesë për shumë veta.**

**Mateu 20:28**

### MADHËSHTIA ËSHTË TË SHËRBESH.

Por kështu nuk do të jetë ndër ju; por kush të dojë të bëhet i madh ndër ju le të jetë shërbenjësi juaj; edhe kush të dojë të jetë i parë ndër ju, le të jetë shërbëtori juaj. Ashtu si Biri i njeriut nuk erdhi që t'i shërbehet, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si shpërblesë për shumë veta.

Mateu 20:26–28



## SEKSIONI 3: ZBATOJE (GRUP I MADH)

### ZBATIMI/

Sipas kritereve të Jezusit, sa i madh je? Pikërisht atëherë kur dishepujt menduan se e kishin kuptuar si funksiononte mbretëria, Jezusi përmbys botën e tyre. Ai u kujtoi se “të parët e kombeve i sundojnë ato dhe të mëdhenjtë përdorin pushtet mbi ato.”

Shumë njerëz mendojnë se fuqia dhe madhështia vijnë nga të qenët sundues në majën e një mali dhe duke e bërë veten zot të të tjerëve. Jezusi dhe mbretëria e Tij nuk funksionojnë ashtu. Në fakt, Jezusi po thotë: a dëshiron të mësosh të dallosh një drejtues, sundues apo dikë të madh? Shiko si shërben. Mënyra si ai shërben do të tregojë nëse po punon për përparimin e mbretërisë së vet apo asaj të Perëndisë.

Po ti? Nëse dikush do të vëzhgonte jetën tënde dhe mënyrën si ti lufton për një mbretëri, çfarë do të dallonin? A të shohin njerëzit si dikush që dëshiron thjesht të veshë një pelerinë, duke mbajtur një titull të rëndësishëm? Apo të shohin si dikush që nuk ka frikë të bëhet pis dhe të shërbejë? Ky është një moment turpërues në Shkrim. Do të ishte njësoj sikur mamaja jote të shkonte te Jezusi për

### FJALË KYÇ/

**AMBICIE:** NJË DËSHIRË E FORTË PËR TË BËRË APO ARRITUR DIÇKA, ZAKONISHT KËRKON VENDOSMËRI DHE SHUMË PUNË

### MENDIMI KYÇ/

**NË MËSIMIN 11, MËSUAM SE, QË NJË BESIMTAR TË JETË I MADH SI JEZUSI, DUHET TË BËHET MË PARË SHËRBËTOR.**

t'i mbushur mendjen të të bënte pjesë të skuadrës. I gjithë diskutimi vuri në siklet gjithë sallën.

Nëse mamaja jote do të shkonte te Jezusi për ta pyetur për pozicionin tënd në mbretëri, çfarë do të thoshte Jezusi? A do të të lavdëronte për zemrën prej shërbëtori? Apo ndoshta do të të sfidonte ta rimendoje edhe njëherë madhështinë? Jezusit nuk i interesojnë titujt, fuqia e asnjë gjëje tjetër që bota e lidh me madhështinë. Jezusi sheh zemrën dhe motivet e njerëzve. Ai po sheh zemrën tënde. A e kupton se çfarë kërkon Ai që ti të shohësh? Çfarë mendon se duhet të ndryshojë në jetën tënde që të jesh plotësisht në drejtimin e Mbretit dhe të mbretërisë së Tij?

### ZBATIMI YT/

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

## SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUP I VOGËL)

### PYETJE NXITËSE/

### KOHA:

Çfarë mendon se duhet të bësh për të qenë i madh?

Çfarë mendon për mënyrën si Jezusi e përshkroi rrugën drejt madhësisë?

### PJESA 3 - LEXO: MATEU 20:20-21

Kjo nënë i kërkoi Jezusit të bënte diçka për të, përpara se t'i tregonte se çfarë ishte ajo gjë. Duket sikur po përpiqej ta manipulonte Jezusin që të thoshte "po" përpara se t'i tregonte kërkesën e madhe. Pse?

### ZBULO:

Përse nuk funksionon kjo gjë me Perëndinë? Si e tregon ti se beson që Perëndia do të të japë përgjigjen e Tij më të dashur, pa u përpjekur ta manipulosh?

### PJESA 4 - LEXO: MATEU 20:22-23

Kupa që Jezusi përshkruan është kupa e vuajtjeve. Ai e dinte se do të pinte prej saj shumë shpejt, dhe se ata që e ndiqnin do të pinin gjithashtu prej saj. Të ndash madhësitinë me Jezusin do të thotë të ndash me Të edhe vuajtjen.

Më pas, Jezusi tregon se Ati ka përgatitur vende nderi në mbretërinë e Jezusit për njerëz të veçantë.

### ZBULO:

Çfarë tregon përgjigja e shpejtë që Jakobi dhe Gjoni i dhanë Jezusit? A mendon se ata e kuptuan vërtet pyetjen e Tij?

Për aq sa ke lexuar nga ky pasazh, ku mendon se do të bazohet Ati kur të përcaktojë kujt i përkasin vendet e nderit?

## SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUP I VOGËL)

### PJESA 5 - LEXO: MATEU 20:24-27

Tronditëse! Dishepujt e tjerë u indinjuan kur morën vesh se Jakobi dhe Gjoni kërkuan vendet e para në qeverinë e Jezusit. Jezusi u tha atyre se drejtuesit në qeverisjen e Tij nuk do të keqpërdorin autoritetin e tyre.

Duket sikur Jezusi po u thotë dishepujve të Tij: "A dëshiron të jesh i madh në këtë grup, në qeverisjen që po vjen? Nëse po, duhet të zbrësesh shkallët. Sa më poshtë të shkosh duke shërbyer, aq më lart do të ngjitesh."

#### ZBULO:

Përshkruaj një rast kur ke qenë përgjegjës për një grup, por personat që ti drejtoje nuk e pranonin autoritetin tënd. Si mundet një drejtues shërbëtor (si Jezusi) t'i bindë njerëzit të bëjnë diçka?

Sa njerëz të mëdhenj njeh që u shërbejnë të tjerëve? Drejt kujt mund të përulesh për t'i shërbyer këtë javë? Kush ulet për të të shërbyer ty?

### PJESA 6 - LEXO: MATEU 20:26-28

Jezusi jep një deklaratë misioni për jetën dhe dishepujt e Tij në këto vargje. Ai e dinte se çfarë qëllimi kishte dhe nuk kishte jeta e Tij. Ai nuk kishte ardhur që t'i shërbenin. Ai ishte këtu për të shërbyer e për të vazhduar duke shërbyer. Njësoj është edhe për ne.

#### ZBULO:

Cili mendon se është qëllimi i jetës tënde? Nëse je i krishterë dhe ndjekës i Krishtit, si e tregon jeta jote se je këtu për t'i shërbyer të tjerëve? Nëse jeta jote nuk e tregon, çfarë mund të ndryshosh që të fillosh ta tregosh këtë gjë?

### PJESA 7

Çfarë mësove për Jezusin këtë javë? Përse është e rëndësishme?

# SEKSIONI 5: VLERËSOJE

## NDIHMË THJESHTËSUESE/

### Mëso emrat e tyre!

Të gjithë e kemi përjetuar këtë. Ke shkuar në një grup të caktuar dhe ta kanë thënë emrin gabim. Ti ke thënë me vete: “Seriozisht?! S'ma di emrin?” Edhe me studentët e tu kështu ndodh. Ky është fillimi i vitit. Bëje qëllim mësimin e emrave të tyre. Mbaj foto të tyre dhe shëno disa prej gjërave të preferuara (p.sh., ëmbëlsira e preferuar, skuadra e preferuar, lënda, libri, filmi, aktiviteti i tyre i preferuar dhe ditëlindjen e tyre). Përdori këto foto si pjesë të vogla lutjeje dhe përdor informacionin e marrë në avantazhin tënd. Mëso dhe studio jetët që përfaqësojnë këta emra. Kështu viti do të ketë një fillim të mbarë.

## VLERËSIMI/

Çfarë shkoi mirë...? Çfarë nuk shkoi dhe aq mirë? Shkruaj si shkoi takimi dhe kaloni kohë rregullisht si skuadër drejtuese duke diskutuar këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në ripërcaktimin e asaj që ti bën dhe ndihmon përmirësimin e takimit çdo javë.

- Përgatite —
- Luaje —
- Mësoje —
- Diskutoje —

## NDJEKJA/

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe gjërat që ndodhin në jetën e studentëve. Përdore këtë hapësirë për të shënuar kërkesat e lutjeve, kontaktet e studentëve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose jepua studentëve që të shënojnë kur do të jetë koncerti apo ndeshja e tyre e radhës.

DATA	EMRI	KËRKESAT/ NGJARJET/ KONTAKTET